

**VENDIM**  
**Nr. 671, datë 7.11.2018**

**PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR  
PËR NOMENKLATURËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën për kryerjen e përditësimit, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- |  |    |
|--|----|
| a) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme       | 1; |
| b) Ministria e Brendshme                           | 1; |
| c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë             | 1; |
| ç) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë       | 1; |
| d) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë         | 1; |
| dh) Ministria e Drejtësisë                         | 1; |
| e) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural      | 1; |
| ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  | 1; |
| f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit               | 1; |
| g) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes | 1; |
| gj) Banka e Shqipërisë                             | 1; |
| h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit                   | 1; |
| i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave             | 1; |
| j) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve             | 1; |
| k) Instituti i Sigurimeve Shoqërore                | 1; |
| l) Qendra Kombëtare e Biznesit                     | 1; |
| ll) INSTAT-i                                       | 2. |

3. Përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komisionit, caktohen nga titullarët e institucioneve, sipas kriterëve e kërkesave të paraqitura nga Instituti i Statistikave, dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve njoftojnë INSTAT-in.

4. Për përgatitjen e mbledhjeve dhe koordinimin e çështjeve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën krijohet sekretariati i Komisionit, i cili përbëhet nga specialistë të Institutit të Statistikave. Rregullat për funksionimin e sekretariatit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën.

5. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mbledhet me thirrjen e kryetarit. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 25.8.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, për çdo mbledhje, është sipas përcaktimit të bërë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”.

7. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mund të ngrejë grupe pune, sipas fushave dhe

nevojave të tij, me përbërje nga të gjitha institucionet e përfshira në Komision ose një pjesë të tyre. Rregullat për funksionimin e këtyre grupeve dhe për shkallën e tyre të përgjegjësisë përcaktohen me vendim të veçantë të këtij Komisioni.

8. Nomenklaturat e miratuara paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

9. Vendimi nr. 426, datë 15.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”, të ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 2, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**